



Republika e Kosovës / Republic of Kosova  
Komuna - Municipality  
Hani i Elezit



01/Nr. 964/2021  
Data: 08.02.2021

**PROCESVERBALI  
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e parë -I- për vitin 2021 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 19.01.2021 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Mallzum Qajani (Nënkyrytar i Komunës), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Sevime Laçi (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), Menduh Vlashi (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Bajrush Laçi (Shef i Zyrës Ligjore), Ibrahim Axhami (Asistent i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës), Bashkim Sopa (Zyrtar për Transparency) Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

**RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë.
3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.
4. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.
5. Informatë mbi epideminë COVID-19 gjatë vittit 2020.
6. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2020.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**U MIRATUA RENDI I PUNËS**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

**MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR**

## **2. Propozim vendim për ndarjen e bursave për studentë.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Menduh Vlashi thekson:-** përvëç materialit të cilin e kam përcjell diçka të veçantë nuk kam. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** në disa drejtime që i keni përcaktuar a ka studentë të cilët nuk janë regjistruar deri më tani. Nëse nuk ka studentë që nuk janë regjistruar është mirë me hulumtar këtë çështje dhe me sensibilizuar që studentët me u regjistruar. Drejtoria për arsim para përfundimit të shkollimit të mesëm me bërë një lloj fushatë për drejtimet deficitare të cilat janë të nevojshme në Han të Elezit.

**Menduh Vlashi thekson:-** ka drejtim që nuk janë regjistruar studentët. Në fakultet të xehetarisë dhe metalurgjisë nuk kemi pasur, në matematik, fizik, kimi. Këto drejtime i ka përcaktuar kuvendi i komunës dhe kemi propozuar fakultet të cilat janë deficit në Han të Elezit. Vitet e kaluara kemi shkuar nëpër shkolla dhe kemi mbajtur takime për çështje të drejtimeve por në ketë vit nuk kemi mundur me mbajtur për shkak të pandemisë dhe nëse hiqen masat që janë të përcaktuara për shkak të pandemisë në këtë vit do të shkojmë.

**Kryesuesi thekson:-** a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **3. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2021.**

**Kryesuesi thekson:-** komiteti për komitete ka hartuar planin e punës për vitin 2021 dhe vërehen disa ndryshime që i ka përshtatur më kuadër të kompetencave që i ka ky komitet. Për vitin 2021 i kanë planifikuar që ti mbajnë dhjetë mbledhje. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** është mirë që në mbledhje të kuvendit të komunës me marr pjesë kryesuest e komiteteve për shkak se ndoshta dikush prej anëtarëve të kuvendit të komunës mund të kërkon ndonjë sqarim.

**Kryesuesi thekson:-** do tu a përcjellim ftesën për me marr pjesë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

### **U VOTUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITETE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

## **4. Plani i punës së katër komiteteve konsultative për vitin 2021.**

**Kryesuesi thekson:-** vitin e kaluar është themeluar edhe komiteti për persona me aftësi të kufizuara. Secili komitet i ka paraparë nga gjashtë mbledhje sipas udhëzimit administrativ. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Teuta Shkreta thekson:-** komiteti për shërbime publike në plan të punës ka paraparë vendim për përcaktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronat e paluajtshme për vitin 2021. Unë mendoj që duhet të modifikohet.

**Mallzum Qajani thekson:-** më mirë do të ishte që të jetë diskutim për caktimin e normave tatimore për tatimin mbi pronat e paluajtshme për vitin vijues.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

## **U VOTUA PLANI I PUNËS SË KATËR KOMITETEVE KONSULTATIVE PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND**

### **5. Informatë mbi epideminë COVID-19 gjatë vitit 2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mallzum Qajani thekson:-** për momentin i kemi vetëm dy raste pozitive. Në QKMF nuk ka vizita të mëdha nga pacientët. Po vazhdohet në QKMF me testet serologjike dhe mbi 800 teste janë kryer, ndërsa një raport më detal për koronavirusin për vitin 2020 do ta përcjellim në muajin shkurt.

**Nora Xhoni thekson:-** në arsim a janë bërë teste serologjike dhe a ka arsimtarë apo profesor që janë me kovid. A mundet procesi mësimorë me vazhduar pa pengesa.

**Mallzum Qajani thekson:-** data e fundit ka qenë 28.12.2020 dhe të gjithë punëtorët të cilët kanë dalur pozitiv në periudhën kur ka filluar procesi mësimorë e kanë kaluar periudhën e vetë izolimit dhe konsiderohen të shëruar.

**Mehmet Ballazhi thekson:-** a e keni diskutuar çështjen e vaksinave se si do të jetë ndarja e tyre nëpër komuna.

**Mallzum Qajani thekson:-** për këtë çështje nuk kemi pranuar diçka zyrtare prej nivelit qendrorë. Prioritet që do të vaksinohen do të janë punëtorët shëndetësore dhe ne e kemi dërguar një listë të cilën na e ka kërkuar Ministria e Shëndetësisë të personave që e kanë kryer apo që kanë problem por edhe të personave të moshës mbi gjashtëdhjetë vjet.

**Kryesuesi thekson:-** a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka kalojmë në pikën e radhës të rendit të punës të paraparë sipas agjendës.

### **6. Informatë mbi veprimtarit e subjekteve afariste për vitin 2020.**

**Kryesuesi thekson:-** lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Sevime Laçi thekson:-** Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik bënë faturimin dhe inkasimin e taksës vjetore për subjektet afariste dhe mban evidenca për këto subjekte. Gjatë vitit 2020 në komunën e Hanit të Elezit kanë qenë 352 biznese aktive nga ky numër 46 biznese janë biznese të reja të regjistruara në vitin 2020 sipas raportit të rregullt vjetor që na informon zyrtari i regjistrimit të bizneseve. Nga ky numër 50 biznese janë me pronare femra, kryesisht biznese individuale me veprimtaritë ndryshme si frizere, rrobaqepëse, restorante, produkte të përpunimit të brumërave dhe shitore tregtare. Gjatë vitit 2020 për shkak të gjendjes së shkatuar nga pandemia COVID 19 si drejtori jemi ballafaquar me probleme në inkasimi e të hyrave vetanake nga subjektet afariste. Si pasojë e pandemisë kemi pasur një rënie të të hyrave gjatë këtij viti dhe kemi arritur të inkasojmë 58,224.99€ ndërsa në vitin 2019 kemi inkasuar 95,276.40 € e që i bie se në vitin 2020 kemi inkasuar më pak kemi pasur rënie për 35,751.41 € apo 35.7%. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

**Teuta Shkreta thekson:-** janë përcaktuar veprimtaritë prodhuese dhe kërkoj sqarim për cilat bëhet fjalë.

**Sevime Laçi** thekson:- bëhet fjalë për gurëthyesit, kompania Sharrcem, industria e mishit.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- potencuat 46 biznese të reja për vitin 2020 dhe u potencua që ka pasur të hyra më pak , a është pandemi që ka ndikuar apo keni identifikuar edhe ndonjë problem tjetër në këtë çështje. A ka biznese të interesuar nga jashtë që të bëjnë investime në Han të Elezit.

**Sevime Laçi** thekson:- probleme ka shkaktuar pandemi. Në muajin janar dhe shkurt i kemi telefonuar pronarët e bizneseve për me i kryer obligimet dhe disa filluan me bërë edhe marrëveshje , mirëpo ka edhe prej tyre që nuk janë përgjigjur dhe i kemi përcjell tetë lëndë në përmbarues. Bizneset e reja të cilat janë me pronare femër lirohen katër vite nga pagesa e taksës komunale, ndërsa nëse pronari është prej gjinisë mashkullorë lirohen dy vite nga pagesa e taksës komunale. Biznese nga jashtë nuk kemi pasur të interesuar për me investuar.

**Kryesuesi** thekson:- te rubrika që i ke paraqitur bizneset, kërkoj që totali i femrave me i vendosë me një rubrikë të veçantë. A ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

#### U VOTUA INFORMATA PËR VEPRIMTARIT E SUBJEKTEVE AFARISTE PËR VITIN 2020 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

##### 7. Të ndryshme.

**Kryesuesi** thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

**Mehmet Ballazhi** thekson:- në shkollën fillore n “Kështjella e Diturisë” ishte katërdhjetë minuta ora , a është morë ndonjë vendim prej nivelit qendrorë .

**Menduh Vlashi** thekson:- vendim nuk është marr por Ministria e Arsimit zyrtarisht ka potencuar se në të gjithë ato shkolla që ekzistojnë kushtet të i kthehen normalitetit në minimum katër dhjetë minuta një orë mësimore.

Mbledhja përfundoi në ora 11:37

Procesmbajtësi

Avni Bushi



Kryesuesi i Kuvendit  
MSc. Qamush Brava